

TË DREJTAT E NJERIUT DHE ZBATUESIT E LIGJIT  
BROSHURË MBI TË DREJTAT E NJERIUT PËR POLICINË



Mission in Kosovo



TË DREJTAT E NJERIUT DHE ZBATUESIT E LIGJIT  
BROSHURË MBI TË DREJTAT E NJERIUT PËR POLICINË

osce

Mission in Kosovo



## Shënim hyrës

Të gjitha autoritet drejtuese janë të detyruara t'i mbrojnë të gjitha të drejtat themelore të njerëzve që ata i shërbejnë. Kjo vlen njejt si për të gjitha autoritetet qeveritare, po ashtu edhe për ato në Kosovë.

Autoritet policore, si pjesë e ekzekutivit të qeverisë, kanë rol të njejt në shoqëri. Duke pasur autoritetin për të zbatuar ligjin e vendit, me force nëse është e nevojshme, policia ka përgjegjësi të madhe ta shrytojë këtë autoritet me kujdesë në mënyrë që të drejtat e gjithë qytetarëve të jenë të mbrojtura. Është e vështirë të mbahet bilanci, mirëpo gabime në një anë ose tjetrën mund të ketë pasoja të mëdha tek njerëzit e prekur, qoftë viktima, të akuzuar, dëshmitar apo spektator.

Në mënyrë që të demonstrojmë si të drejtat e njeriut janë të aplikueshme në Kosovë, dispozitat nga instrumentet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut dhe nga ligji i aplikueshëm në Kosovë janë përfshi në këtë broshurë. Informatat dhe dispozitat të përfshira në këtë broshurë janë zgjedhur posaqërisht për punën e policisë.

Së fundi, dëshiroj ta falenderoj stafin që kanë kontribuar në publikimin kësaj broshure, posaqërisht Lumnije Shkodra, Monitorusja Vendore e Gjykatës, në zyrën OSBE-es në Gjiilan/Gnjilane.

Shpresoj që kjo broshurë do t'ju shërbejë si referim i nevojshëm në punën tuaj të rëndësishme. Si pjesë e forcës policore në Kosovë, ju luani një rol të rëndësishëm në mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe ruajtjen e sundimit të ligjit.

*Henry W. McGowen*

*Drejtor*

*Drejtat e Njeriut dhe Sundimit të së Drejtës  
OSBE, Misioni në Kosovë*

## Përmbajtja

Shkurtesat	7
E drejta për liri dhe siguri	8
Arresti	8
Marrja në pyetje	12
E drejta ne avokat	14
E drejta për një proces të rregullt	15
Prezumimi i pafajsis	17
Policia si dëshmitar ne sistemin juridik	18
Tortura/Dhuna	18
Të miturit	19
E drejta për respektimin e jetës private dhe familjare	22
Diskriminimi	23
E drejta për ankim efektiv	24
E drejta për të mos u gjykuar ose dënuar dy herë	24
Robëria	25
E drejta për dëmshpërblim	25
Urdhërkontrolli	26
Liria e shprehjes	28
Liria e tubimit dhe e organizimit	29
Veprat Penale Kundër Detyrës Zyrtare	30
Listë faqesh dhe adresash interneti për të drejtat e njeriut	33

## SHKURTESAT

- KPPK** - KODI I PËRKOSSHËM PENAL I KOSOVËS
- KPPPK** - KODI I PËRKOSSHËM I PROCEDURËS PENAL I KOSOVËS
- LPMK** - LIGJI PENAL PËR TË MITUR I KOSOVËS
- ECHR** - KONVENTA E MBROJTJES SE TE DREJTAVE TE NJERIUT DHE LIRIVE THEMELORE
- ICCPR** - PAKTI NDËRKOMBËTAR PËR TË DREJTAT CIVILE DHE POLITIKE
- CAT** - KONVENTA KUNDËR TORTURËS DHE TRAJTIMEVE APO DËNIMEVE TË TJERA MIZORE, Ç'NJERËZORE OSE POSHTËRUESE
- CRC** - KONVENTA PËR TË DREJTAT E FËMIJËS
- CEDAW** - KONVENTA PËR ELIMINIMIN E TË GJITHA FORMAVE TË DISKRIMINIMIT NDAJ GRAVE
- CERD** - KONVENTA NDËRKOMBËTARE PËR ELIMINIMIN E TË GJITHA FORMAVE TË DISKRIMINIMIT RACIAL

## **E drejta për liri dhe siguri**

Çdokush ka të drejtën e lirisë e të sigurisë personale. Askujt nuk mund t'i hiqet liria, me përjashtim të rasteve që vijojnë dhe në përputhje me procedurën e parashikuar me ligj (Neni 5 (1) ECHR)

### **Arresti**

Çdo person i privuar nga liria menjëherë njoftohet në gjuhën që ai e kupton për: (Neni 14 (1) KPPPK)

Arsyet e arrestit të tij; (Neni 14 (1) (1) KPPPK)

Të drejtën në mbrojtës sipas zgjedhjes së tij dhe (Neni 14 par 1 (2) KPPPK)

Të drejtën që lidhur me arrestin të njoftojë ose të njoftohet anëtar i familjes ose personi tjetër përkatës sipas zgjedhjes së tij. (Neni 14 par 1(3) KPPPK)

Personi i privuar nga liria me dyshim se ka kryer veprë penale dërgohet menjëherë para gjyqtarit dhe jo më vonë se brenda 72 orëve nga arresti, ndërsa ai ka të drejtë në gjykim Brenda një kohe të arsyeshme ose të lirohet në pritje të gjykimit. (Neni 14 (2) KPPPK)

Personi i privuar nga liria gëzon të drejtat e parapara me këtë nen gjatë gjithë kohës së heqjes së lirisë. Këto të drejta mund të hiqen vetëm nëse heqja e tillë bëhet vullnetarisht dhe me shkrim. Ushtrimi i këtyre të drejtave nuk varet as nga vendimi i mëparshëm i mundshëm i personit lidhur me heqjen dorë nga të drejtat e caktuara dhe as nga koha e njoftimit për këto të drejta. (Neni 14 (3) KPPPK)

Kur një person kapet në flagrancë gjatë kryerjes së veprës penale e cila ndiqet sipas detyrëszyrtare ose është në ndjekje për veprën e kryer penale, policia ose çdo person tjetër është i autorizuar ta arrestojë atë përkohësisht edhe pa urdhrë të gjykatës. Personi të cilit i është hequr liria nga persona të tjerë përpos policisë, menjëherë i dorëzohet policisë, e kur kjo është e pamundur menjëherë njoftohet policia ose prokurori publik. Policia vepron në pajtim me nenin 211 dhe 212 të këtij Kodi. (Neni 210 KPPPK)

Policia mund të privojë personin nga liria kur ekzistojnë arsyet për ndalim nga neni 281, paragrafi 1 i këtij Kodi, por detyrohet që pa vonesë ta sjellë te gjyqtari i



procedurës paraprake për të vendosur mbi paraburgimin. (Neni 211 KPPPK)

Në rrethana të ngutshme, policia mund të arrestojë dhe të ndalojë personin kur: (Neni 212 (1) KPPPK)

Ekziston dyshim i bazuar se ai ka kryer veprë penale që ndiqet sipas detyrës zyrtare; (Neni 212 (1) (1) KPPPK)

Arrestimi dhe ndalimi është i nevojshëm për identifikimin e personit, verifikimi e alibisë, mbledhjen e informacioneve dhe të të dhënave për veprën penale në fjalë dhe (Neni 212 par (1) (2) KPPPK)

Ekzistojnë arsye për ndalim nga neni 281, paragrafi 1, nënparagrafi 2, pikat (i) dhe (iii) të këtij Kodi, ose kur ka arsye për t'u frikësuar se personi mund të asgjësojë gjurmët e veprës penale (neni 281, paragrafi 1, nënparagrafi 2, pika (ii) e këtij Kodi). (Neni 212 (1) (3) KPPPK)

Arrestimi dhe ndalimi nga paragrafi 1 i këtij neni autorizohet nga prokurori publik ose, kur për shkak të rrethanave të ngutshme autorizimi i tillë nuk mund të merret para arrestimit, nga policia e cila menjëherë duhet të informojë prokurorin publik pas arrestimit. (Neni 212 (2) KPPPK)

Me rastin e arrestimit personi i arrestuar informohet: (Neni 212 (3) KPPPK)

Gojarisht për të drejtat e parapara nga neni 214 i këtij Kodi (Neni 212 (3) (1) KPPPK) dhe

Me shkrim për të drejtat tjera të cilat ai i gëzon sipas këtij Kodi. (Neni 212 (3) (2) KPPPK)

Ndalimi nga ky nen nuk mund të kalojë shtatëdhjetë e dy orë nga koha e arrestimit. Pas kalimit të këtij afati, policia e liron të ndaluarin, përveç rasteve kur gjyqtari i procedurës paraprake ka urdhëruar paraburgimin. (Neni 212 (4) KPPPK)

Sa më shpejtë që është e mundur pas arrestimit, jo më vonë se gjashtë orë nga koha e arrestimit, prokurori publik ose oficeri i lartë i autorizuar i policisë personit të arrestuar i lëshon vendim mbi ndalimin i cili përfshin emrin dhe mbiemrin e personit të arrestuar, vendin, ditën dhe kohën e saktë të arrestimit, veprën penale për të cilën dyshohet, bazën juridike për arrestim dhe udhëzimin për të drejtën në ankesë. (Neni 212 (5) KPPPK)

Personi i arrestuar ka të drejtë të kundërshtojë vendimin nga paragrafi 5 i këtij neni të gjyqtari i procedurës paraprake. Policia dhe prokurori publik detyrohen të sigurojnë që ankesa t'i jetë dërguar gjyqtarit të procedurës paraprake. Ankesa nuk e pezullon ekzekutimin e vendimit. Gjyqtari i procedurës paraprake vendos për ankesë brenda njëzet e katër orëve nga momenti i arrestimit. (Neni 212 (6) KPPPK)

Personi i arrestuar ka të drejtë të komunikojë në mënyrë konfidenciale me mbrojtësin e tij gojarisht dhe me shkrim. Komunikimi ndërmjet të arrestuarit dhe mbrojtësit të tij mund të vëzhgohet, por jo të ndëgjohet nga policia. (Neni 213 (3) KPPPK)

Personi i arrestuar gëzon këto të drejta: (Neni 214 (1) KPPPK)

Të informohet në gjuhën që ai e kupton për arsyet e arrestimit; (Neni 214 (1) (1) KPPPK)

Të heshtë dhe të mos përgjigjet në asnjë pyetje, përveç dhënies së informative mbi identitetin e tij; (Neni 214 (1) (2) KPPPK)

T'i sigurohet përkthim falas nëse nuk e kupton ose nuk e flet gjuhën e policit; (Neni 214 (1) (3) KPPPK)

Të shfrytëzojë ndihmën e mbrojtësit dhe t'i caktohet mbrojtës nëse nuk ka mundësi të paguajë për ndihmë ligjore; (Neni 214 (1) (4) KPPPK)

Për arrestimin e tij të lajmërojë ose të kërkojë nga policia ta lajmërojë anëtarin e familjes ose ndonjë person tjetër sipas zgjedhjes së tij dhe (Neni 214 (1) (5) KPPPK)

Të ketë kontroll dhe trajtim mjekësor duke përfshirë edhe trajtimin psikiatrik. (Neni 214 (1) (6) KPPPK)

Kur personi i arrestuar është shtetas i huaj, ai ka të drejtë të njoftojë ose të kërkojë të njoftohet dhe të komunikojë gojarisht a me shkrim me zyrën e ndërlidhjes, me misionin diplomatik të shtetit, shtetas i të cilit është ai ose me përfaqësuesin e organizatës kompetente ndërkombëtare kur ai është refugjat ose është nën mbrojtjen e ndonjë organizate ndërkombëtare. (Neni 214 (2) KPPPK)

Personi i arrestuar ka të drejtë që menjëherë pas arrestimit të lajmërojë ose të

kërkojë nga policia që të lajmërojnë anëtarin e familjes ose ndonjë person tjetër sipas zgjedhjes së tij për arrestimin dhe vendin e ndalimit dhe për çdo ndryshim të mëvonshëm të vendit të ndalimit menjëherë pas ndryshimit të tillë. (Neni 215 (1) KPPPK)

Kur personi i arrestuar nuk e ka mbushur moshën tetëmbëdhjetë vjet, policia menjëherë pas arrestimit e lajmëron përfaqësuesin ligjor të personit të arrestuar për arrestimin dhe vendin e ndalimi dhe për çdo ndryshim të mëvonshëm të vendit të ndalimit menjëherë pas ndryshimit të vendit të ndalimit. Kur lajmërimi i tillë është i pamundur ose do të ishte i dëmshëm për interesat e personit të arrestuar, apo shprehimisht refuzohet nga personi i arrestuar, policia e lajmëron qendrën për punë sociale. (Neni 215 (2) KPPPK)

Kur personi i arrestuar tregon shenja të çrregullimit mendor ose të paaftësisë mendore, policia menjëherë pas arrestimit njofton personin e caktuar nga personi i arrestuar dhe qendrën për punë sociale për arrestimin dhe vendin e ndalimit dhe për çdo ndryshim të mëvonshëm të vendit të ndalimit menjëherë pas ndryshimit të tillë. (Neni 215 (3) KPPPK)

Lajmërimi i anëtarëve të familjes dhe i personave të tjerë përkatës në pajtim me paragrafët 1 dhe 2 të këtij neni mund të vonohet deri në 24 orë kur prokurori publik çmon se kjo kushtëzohet me nevoja të jashtëzakonshme për hetimin e rastit. Vonesë të tillë nuk ka kur personi i arrestuar është nën moshën tetëmbëdhjetë vjet ose tregon shenja të çrregullimit a të paaftësisë mendore. (Neni 215 (4) KPPPK)

Çdo person i arrestuar duhet të informohet, brenda një afati sa më të shkurtër dhe në një gjuhe që ai e kupton, për arsyet e arrestimit të tij dhe në lidhje me çdo akuzë që i bëhet. (Neni 5 (2) ECHR)

Çdo person i arrestuar ose i paraburgosur në rrethanat e parashikuara në paragrafin 1/c të këtij neni, duhet të çohet menjëherë përpara një gjykatësi ose një magjistrati tjetër të autorizuar me ligj për të ushtruar funksione gjyqësore dhe ka të drejtë të gjykohet brenda një afati të arsyeshëm ose të lirohet gjatë proçedurës. Lirimi mund të kushtëzohet me një garanci që siguron paraqitjen e personit në fjalë në gjykim. (Neni 5 (3) ECHR)

Çdo person, të cilit i është hequr liria me arrestim ose me burgim, ka të drejtë

të bëjë ankim në gjykatë me qëllim që kjo e fundit të vendosë, brenda një afati të shkurtër, për ligjshmërinë e burgimit të tij dhe të urdhërojë lirimin, në qoftë se burgimi është i paligjshëm. (Neni 5 (4) ECHR)

Çdo person, që arrestohet ose burgoset në rrethana që bien ndesh me dispozitat e këtij neni ka të drejtën e dëmshpërblimit. (Neni 5 (5) ECHR)

Secili ka të drejtën e lirisë dhe të sigurisë së personit të tij. Askush nuk duhet të jetë objekt i një arrestimi ose burgimi arbitrar. Askush nuk duhet të privohet nga liria, përveç për arsye dhe në përputhje me procedurën e parashikuar me ligj. (Neni 9 (1) ICCPR)

Çdo person i arrestuar duhet të informohet, në çastin e arrestimit, për arsyet e arrestimit dhe menjëherë duhet të njoftohet lidhur me çdo akuzë që bëhet kundër tij. (Neni 9 (2) ICCPR)

Çdo person i arrestuar ose i ndaluar për shkak të një veprë penale duhet të nxirret, pa vonesë, përpara një gjykatësi ose ndonjë zyrtari tjetër të autorizuar me ligj për ushtrimin e funksioneve gjyqësore dhe duhet të gjykohet brenda një afati të arsyeshëm ose të lirohet. Ndalimi i personave të cilët presin të gjykoohen nuk duhet të jetë rregull i përgjithshëm, por lirim mund të kushtëzohet me garanci për të siguruar daljen e të interesuarit para gjyqit, në cilëndo fazë tjetër të procedurës gjyqësore, dhe po qe se paraqitet nevoja, edhe për ekzekutimin e gjykimit. (Neni 9 (3) ICCPR)

Çdo person që privohet nga liria e tij me masa arrestimi ose ndalimi ka të drejtë ankese në një gjykatë me qëllim që kjo të vendosë, pa vonesë, lidhur me ligjshmërinë e masës së ndalimit dhe të urdhërojë lirimin e tij në qoftë se ndalimi është i paligjshëm. (Neni 9 (4) ICCPR)

Çdo person që është viktimë e një arrestimi ose ndalimi të paligjshëm ka të drejtë dëmshpërblimi. (Neni 9 (5) ICCPR)

## **Marrja ne Pyetje**

Që nga marrja në pyetje për herë të parë, i pandehuri menjëherë njoftohet në hollësi për llojin dhe shkaqet e akuzës kundër tij në gjuhën që ai e kupton. (Neni

11 (1) KPPPK)

I pandehuri nuk ka detyrim të paraqesë mbrojtjen e vet ose t'i përgjigjet ndonjë pyetje, dhe nëse mbrohet, nuk është i detyruar të akuzojë vetveten ose të afërmin e tij e as të pranojë fajësinë. (Neni 11 (2) KPPPK)

Nga i pandehuri ose personi tjetër që merr pjesë në procedurë ndalohet dhe dënohet që të imponohet pranimi i fajësisë ose ndonjë deklaram tjetër me anë të torturës, forcës, kanosjes apo nën ndikimin e drogës ose të masave të tjera të ngjashme. (Neni 11 (3) KPPPK)

Personi i arrestuar gëzon këto të drejta: (Neni 214 (1) KPPPK)

Të informohet në gjuhën që ai e kupton për arsyet e arrestimit; (Neni 214 (1) (1) KPPPK)

Të heshtë dhe të mos përgjigjet në asnjë pyetje, përveç dhënies së informative mbi identitetin e tij; (Neni 214 (1) (2) KPPPK)

T'i sigurohet përkthim falas nëse nuk e kupton ose nuk e flet gjuhën e policit; (Neni 214 (1) (3) KPPPK)

Të shfrytëzojë ndihmën e mbrojtësit dhe t'i caktohet mbrojtës nëse nuk ka mundësi të paguajë për ndihmë ligjore; (Neni 214 (1) (4) KPPPK)

Kur personi i arrestuar është shtetas i huaj, ai ka të drejtë të njoftojë ose të kërkojë të njoftohet dhe të komunikojë gojariht a me shkrim me zyrën e ndërlidhjes, me misionin diplomatik të shtetit, shtetas i të cilit është ai ose me përfaqësuesin e organizatës kompetente ndërkombëtare kur ai është refugjat ose është nën mbrojtjen e ndonjë organizate ndërkombëtare. (Neni 214 (2) KPPPK)

Gjatë çdo marrjeje në pyetje nga policia, personi i arrestuar ka të drejtë në praninë e mbrojtësit. Nëse mbrojtësi nuk paraqitet brenda dy orëve pas informimit për arrestimin, policia i cakton mbrojtës tjetër. Më tutje, nëse mbrojtësi tjetër nuk paraqitet brenda një ore pas informimit nga policia, personi i arrestuar mund të merret në pyetje vetëm kur prokurori publik ose policia çmon se shtyrja e mëtejshme do të rrezikojë seriozisht zbatimin e hetimit. (Neni 218 (1)K)

Secili person i akuzuar për një vepër penale ka të drejtë plotësisht të barabartë të ketë këto garanci minimale: (Neni 14 (3) ICCPR)

Të informohet menjëherë dhe në mënyrë të hollësishme, në një gjuhë të cilën ai e kupton, lidhur me natyrën dhe shkakun e akuzës që ngrihet kundër tij; (Neni 14 (3) (a) ICCPR)

Të ketë kohë dhe mundësi të mjaftueshme për të përgatitur mbrojtjen dhe të komunikojë me një avokat të zgjedhur prej tij; (Neni 14 (3) (b) ICCPR)

Të ketë ndihmën falas të një përkthyesi në qoftë se nuk kupton ose nuk flet gjuhën që përdoret në gjyq; (Neni 14 (3) (dh) ICCPR)

Të mos shtrëngohet të dëshmojë kundër vetvetes ose të pranojë se është fajtor. (Neni 14 (3) (e) ICCPR)

## **E drejta ne avokat**

I pandehuri ka të drejtë të mbrohet personalisht ose me ndihmën e mbrojtësit i cili është anëtar i shoqatës së avokatëve, sipas zgjedhjes së tij. (Neni 12 (2) KPPPK)

Në qoftë se i pandehuri nuk angazhon mbrojtës për të siguruar mbrojtjen, kurse mbrojtja është e detyrueshme, të pandehurit i caktohet mbrojtës i pavarur me përvojë dhe me kompetence në përputhje me llojin e veprës penale dhe sipas kushteve të parapara me këtë Kod. (Neni 12 (3) KPPPK)

Gjykata ose personi tjetër kompetent i cili e drejton procedurën penale detyrohet ta njoftojë të pandehurin për të drejtën e tij në mbrojtës që nga marrja në pyetje për herë të pare, ashtu siç parashihet me këtë Kod. (Neni 12 (5) KPPPK)

Në pajtim me dispozitat e këtij Kodi, çdo person i privuar nga liria ka të drejtë në shërbimet e mbrojtësit që nga arresti e tutje. (Neni 12 (6) KPPPK)

Personi i arrestuar ka të drejtë të komunikojë në mënyrë konfidenciale me mbrojtësin e tij gojarisht dhe me shkrim. Komunikimi ndërmjet të arrestuarit dhe mbrojtësit të tij mund të vëzhgohet, por jo të ndëgjohet nga policia. (Neni 213 (3) KPPPK)

Gjatë çdo marrjeje në pyetje nga policia, personi i arrestuar ka të drejtë në praninë e mbrojtësit. Nëse mbrojtësi nuk paraqitet brenda dy orëve pas informimit për arrestimin, policia i cakton mbrojtës tjetër. Më tutje, nëse mbrojtësi tjetër nuk

paraqitet brenda një ore pas informimit nga policia, personi i arrestuar mund të merret në pyetje vetëm kur prokurori publik ose policia çmon se shtyrja e mëtejshme do të rrezikojë seriozisht zbatimin e hetimit. (Neni 218 (1) KPPPK)

Çdo i akuzuar ka të drejtë, sidomos, që.: (Neni 6 (3) ECHR)

të mbrohet vetë ose të ndihmohet nga një mbrojtës i zgjedhur prej tij dhe, në qoftë se ai nuk ka mjete për të shpërblyer mbrojtësin, t'i mundësohet ndihma falas nga një avokat i caktuar zyrtarisht, kur këtë e kërkojnë interesat e drejtësisë; (Neni 6 (3) (c) ECHR)

Secili person i akuzuar për një vepër penale ka të drejtë plotësisht të barabartë të ketë këto garanci minimale: (Neni 14 (3) ICCPR)

Të ketë kohë dhe mundësi të mjaftueshme për të përgatitur mbrojtjen dhe të komunikojë me një avokat të zgjedhur prej tij; (Neni 14 (3) (b) ICCPR)

Të jetë i pranishëm gjatë procesit dhe të mbrohet vetë ose nëpërmjet një mbrojtësi të zgjedhur prej tij; në qoftë se nuk ka mbrojtje, duhet të informohet për të drejtën e tij që të ketë një të tillë dhe, kurdoherë që e kërkon interesi i drejtësisë, atij duhet t'i caktohet një mbrojtje falas në cilindo rast të tillë nëse ai nuk ka mjete për të paguar; (Neni 14 (3) (ç) ICCPR)

## **E drejta për një proces të rregullt**

Çdo person i dyshuar ose i akuzuar për vepër penale ka të drejtë të kërkojë procedurë të paanshme penale të zbatuar në kohë të arsyeshme. (Neni 5 (1) KPPPK)

Çdo heqje lirie, e sidomos kohëzgjatja e paraburgimit në procedurë penale, duhet zvogëluar në kohën sa më të shkurtër të mundshme. (Neni 5 (3) KPPPK)

Gjykata, prokurori publik dhe policia të cilët marrin pjesë në procedurën penale detyrohen që saktësisht dhe tërësisht t'i vërtetojnë faktet që janë të rëndësishme për marrjen e vendimit të ligjshëm. (Neni 7 (1) KPPPK)

Çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e

krijuar me ligj, e cila do të vendosë si për mosmarrëveshjet në lidhje me të drejtat dhe detyrimet e tij të natyrës civile, ashtu edhe për bazueshmërinë e çdo akuze të natyrës penale që i është drejtuar.(...). (Neni 6 (1) ECHR)

Çdo person i akuzuar për një vepër penale prezumohet i pafajshëm derisa fajësia e tij të provohet ligjërisht. (Neni 6 (2) ECHR)

Çdo i akuzuar ka të drejtë, sidomos, që,: (Neni 6 (3) ECHR)

të informohet, brenda një afati sa më të shkurtër, në një gjuhë që ai e kupton dhe në mënyrë të hollësishme, për natyrën dhe për shkakun e akuzës që i bëhet; (Neni 6 (3) (a) ECHR)

t'i jepet koha dhe lehtësitë e nevojshme për përgatitjen e mbrojtjes; (Neni 6 (3) (b) ECHR)

të mbrohet vetë ose të ndihmohet nga një mbrojtës i zgjedhur prej tij dhe, në qoftë se ai nuk ka mjete për të shpërblyer mbrojtësin, t'i mundësohet ndihma falas nga një avokat i caktuar zyrtarisht, kur këtë e kërkojnë interesat e drejtësisë; (Neni 6 (3) (c) ECHR)

të pyesë, ose të kërkojë që të merren në pyetje dëshmitarët e akuzës dhe të ketë të drejtën e thirrjes e të pyetjes së dëshmitarëve që e shfajësojnë, në kushte të njëjta me dëshmitarët e akuzës; (Neni 6 (3) (d) ECHR)

të ndihmohet falas nga një përkthyes, në qoftë se nuk kupton ose nuk flet gjuhën e përdorur në gjyq. (Neni 6 (3) (e) ECHR)

Të gjithë janë të barabartë përpara gjykatave dhe organeve të drejtësisë. Çdo person ka të drejtë që çështja e tij të trajtohet me paanësi dhe publikisht nga një gjykatë kompetente, e pavarur dhe e paanshme, e ngritur sipas ligjit, që do të vendosë qoftë për përcaktimin e çdo akuze të karakterit penal që drejtohet kundër tij, qoftë për konfliktet lidhur me të drejtat dhe detyrimet e tij në fushën civile. (...) (Neni 14 (1) ICCPR)

Secili person i akuzuar për një vepër penale ka të drejtë të konsiderohet i pafajshëm derisa fajësia e tij të provohet në përputhje me ligjin. (Neni 14 (2) ICCPR)

Secili person i akuzuar për një vepër penale ka të drejtë plotësisht të barabartë të



ketë këto garanci minimale: (Neni 14 (3) ICCPR)

Të informohet menjëherë dhe në mënyrë të hollësishme, në një gjuhë të cilën ai e kupton, lidhur me natyrën dhe shkakun e akuzës që ngrihet kundër tij; (Neni 14 (3) (a) ICCPR)

Të ketë kohë dhe mundësi të mjaftueshme për të përgatitur mbrojtjen dhe të komunikojë me një avokat të zgjedhur prej tij; (Neni 14 (3) (b) ICCPR)

Të gjykohet pa vonesë të tepruar. (Neni 14 (3) (c) ICCPR)

Të jetë i pranishëm gjatë procesit dhe të mbrohet vetë ose nëpërmjet një mbrojtësi të zgjedhur prej tij; në qoftë se nuk ka mbrojtje, duhet të informohet për të drejtën e tij që të ketë një të tillë dhe, kurdoherë që e kërkon interesi i drejtësisë, atij duhet t'i caktohet një mbrojtje falas në cilindo rast të tillë nëse ai nuk ka mjete për të paguar; (Neni 14 (3) (ç) ICCPR)

Të marrë në pyetje ose të kërkojë të merren në pyetje dëshmitarët kundër tij dhe të sillen në gjyq e të merren në pyetje dëshmitarët e mbrojtjes në emër të tij në të njëjtat kushte sikurse edhe dëshmitarët kundër tij; (Neni 14 (3) (d) ICCPR)

Të ketë ndihmën falas të një përkthyesi në qoftë se nuk kupton ose nuk flet gjuhën që përdoret në gjyq; (Neni 14 (3) (dh) ICCPR)

Të mos shtrëngohet të dëshmojë kundër vetvetes ose të pranojë se është fajtor. (Neni 14 (3) (e) ICCPR)

### **Prezumimi i pafajsis**

Çdo person i dyshuar ose që akuzohet se ka kryer vepër penale konsiderohet i pafajshëm derisa të vërtetohet fajësia e tij me aktgjykim të formës së prerë. (Neni 3 (1) KPPPK)

Çdo person i akuzuar për një vepër penale prezumohet i pafajshëm derisa fajësia e tij të provohet ligjërisht. (Neni 6 (2) ECHR)

Secili person i akuzuar për një vepër penale ka të drejtë të konsiderohet i pafajshëm derisa fajësia e tij të provohet në përputhje me ligjin. (Neni 14 (2) ICCPR)

## **Policia si dëshmitar ne sistemin juridik**

Çdo i akuzuar ka të drejtë, sidomos, që, (Neni 6 (3) ECHR)

të pyesë, ose të kërkojë që të merren në pyetje dëshmitarët e akuzës dhe të ketë të drejtën e thirrjes e të pyetjes së dëshmitarëve që e shfajësojnë, në kushte të njëjta me dëshmitarët e akuzës; (Neni 6 (3) (d) ECHR)

Të marrë në pyetje ose të kërkojë të merren në pyetje dëshmitarët kundër tij dhe të sillen në gjyq e të merren në pyetje dëshmitarët e mbrojtjes në emër të tij në të njëjtat kushte sikurse edhe dëshmitarët kundër tij; (Neni 14 (3) (d) ICCPR)

## **Tortura/Dhuna**

Askush nuk mund t'i nënshtrohet torturës, as dënimeve ose trajtimeve ç'njerëzore ose poshtëruese. (Neni 3 ECHR)

Të gjithë personat e privuar nga liria, duhet të trajtohen me humanizëm dhe respekt për dinjitetin e lindur të njeriut. (Neni 10 (1) ICCPR)

Asnjë rrethanë e jashtëzakonshme, e çfarëdo lloji, qoftë gjendje e luftës ose kërcënim nga lufta, paqëndrueshmëri e brendshme politike apo çdo gjendje tjetër e jashtëzakonshme, nuk mund të shërbejë si shfajësim për torturën. (Neni 2 (2) CAT)

Urdhëri i dhënë nga një eprror ose autoritet publik nuk mund të shërbejë si shfajësim për torturën. (Neni 2 (3) CAT)

Çdo shtet palë i siguron çdo personi që pretendon se i është nënshtuar torturës në cilindo territor nën juridiksionin e tij të drejtën e ankimit pranë autoriteteve kompetente të shtetit në fjalë, të cilat do ta shqyrtojnë çështjen menjëherë dhe me paanësi. Do të merren masa për të siguruar mbrojtjen e ankuesit dhe të dëshmitarëve kundër keqtrajtimit ose frikësimit si pasojë e ankimit ose e dhënies së një dëshmie. (Neni 13 CAT)

Çdo shtet palë, në sistemin e vet juridik, i siguron viktimës së një akti të torturës të drejtën për të kërkuar reparacion dhe për t'u dëmshpërblyer me drejtësi dhe në mënyrë adekuate, duke përfshirë mjetet e nevojshme për riaftësim sa më të shpejtë. Në rast të vdekjes së viktimës si pasojë e një veprimi të torturës, ata që

kanë pasur pasoja prej saj kanë të drejtë për dëmshpërblim. (Neni 14 (1) CAT)

Ky nen nuk përjashton asnjë të drejtë për dëmshpërblimin të cilin viktimat ose personat e tjerë do t'i gëzonin në bazë të ligjeve të vendit. (Neni 14 (2) CAT)

Çdo shtet palë siguron për çdo deklaratë e cila është provuar të jetë marrë nëpërmjet torturës, të mos përdoret si element prove në një proces, përveç rastit kur ky fakt përdoret kundër personit të akuzuar për torturë për të provuar se është dhënë deklarata. (Neni 15 CAT)

### **Të miturit**

Kur personi i arrestuar nuk e ka mbushur moshën tetëmbëdhjetë vjet, policia menjëherë pas arrestimit e lajmëron përfaqësuesin ligjor të personit të arrestuar për arrestimin dhe vendin e ndalimi dhe për çdo ndryshim të mëvonshëm të vendit të ndalimit menjëherë pas ndryshimit të vendit të ndalimit. Kur lajmërimi i tillë është i pamundur ose do të ishte i dëmshëm për interesat e personit të arrestuar, apo shprehimisht refuzohet nga personi i arrestuar, policia e lajmëron qendrën për punë sociale. (Neni 215 (2) KPPPK)

Lajmërimi i anëtarëve të familjes dhe i personave të tjerë përkatës në pajtim me paragrafët 1 dhe 2 të këtij neni mund të vonohet deri në 24 orë kur prokurori publik çmon se kjo kushtëzohet me nevoja të jashtëzakonshme për hetimin e rastit. Vonesë të tillë nuk ka kur personi i arrestuar është nën moshën tetëmbëdhjetë vjet ose tregon shenja të çrregullimit a të paaftësisë mendore. (Neni 215 (4) KPPPK)

Sistemi i drejtësisë për të mitur synon mirëqenien e të miturit dhe siguron që çdo reagim ndaj kryerësve të mitur të jetë gjithmonë në proporcion me rrethanat e kryerësit dhe veprës penale. (Neni 1 (1) LPM)

Kryerësve të mitur u shqiptohen masa të diversitetit sipas nevojës. (Neni 1 (2) LPM)

Privimi i lirisë do të shqiptohet vetëm si mjet i fundit dhe do të kufizohet në afatin më të shkurtër të mundshëm. Gjatë privimit të lirisë të shqiptuar si dënim, kryerësit të mitur i ofrohet edukim, ndihmë psikologjike, e sipas nevojës edhe ndihmë mjekësore për të lehtësuar rehabilitimin e tij. (Neni 1 (3) LPM)

Fëmijës që merr pjesë në procedurë penale i ofrohet mundësia që të shprehet lirish. (Neni 1 (4) LPM)

Çdo fëmijë i privuar lirie trajtohet me humanizëm për hir të dinjitetit të personalitetit të tij njerëzor, dhe me atë rast merren parasysh nevojat personale të moshës së tij. Në veçanti, çdo fëmijë i privuar lirie ndahet nga madhorët, përpos nëse konsiderohet se është në interes të fëmijës të mos ndahet, dhe gëzojnë të drejtën e mbajtjes së kontakteve me familjen e tij përmes korrespondencave dhe vizitave, përveç rrethanave të jashtëzakonshme të përcaktuara me ligj. (Neni 1 (5) LPM)

Çdo fëmijë i privuar lirie ka të drejtë në qasje të menjëhershme në ndihmë ligjore dhe ndihmë tjetër adekuate, si dhe të drejtën për të kundërshtuar ligjshmërinë e privimit të tij nga liria pranë një gjykate të pavarur dhe të paanshme, si dhe në procedurë të menjëhershme. (Neni 1 (6) LPM)

Për t'iu shmangur lëndimit për shkak të publicitetit të tepruar ose etiketimeve, e drejta e fëmijës për privatësi respektohet në të gjitha fazat. Në parim, nuk botohet asnjë informacion që shpie në identifikimin e kryerësit të mitur. (Neni 1 (7) LPM)

Procedura që zbatohet për të miturit të cilët nuk kanë arritur ende moshën madhore, në rast se kanë të bëjnë me ligjin penal, duhet të marrë parasysh moshën e tyre dhe interesin që paraqet riedukimi i tyre. (Neni 14 (4) ICCPR)

Asnjë fëmijë nuk duhet t'u nënshtrohet ndërhyrjeve arbitrare ose të paligjshme në jetën e tij private, në familje, në shtëpi ose në letërkëmbimin e tij, as cenimeve të kundërligjshme të nderit dhe reputacionit të tij. (Neni 16 (1) CRC)

Shtetet palë sigurojnë që: (Neni 37 CRC)

Asnjë fëmijë të mos i nënshtrohet torturës, as trajtimeve ose dënimeve mizore, çnjerëzore ose poshtëruese. As dënimi me vdekje, as burgimi i përjetshëm nuk duhet të jepen për shkelje të ligjit të kryera nga persona nën 18 vjeç; (Neni 37 (a) CRC)

Asnjë fëmijë të mos i mohohet liria në mënyrë të paligjshme ose arbitrare. Arrestimi, ndalimi ose burgimi i një fëmije duhet të jetë në përputhje me ligjin dhe të përdoret vetëm si masë e fundit dhe për një kohë të përshtatshme sa më të shkurtër. (Neni 37 (b) CRC)

Çdo fëmijë i privuar nga liria duhet të trajtohet në mënyrë njerëzore dhe me

respektin që i takon dinjitetit të lindur të njeriut dhe në mënyrën e cila merr parasysh nevojat e personave të moshës së tij. Në veçanti, çdo fëmijë i privuar nga liria duhet të veçohet nga të rriturit, me përjashtim të rastit kur mendohet se është në interesin me të lartë të fëmijës që kjo të shmanget dhe ai të ketë të drejtën të mbajë lidhje me familjen me korrespondencë dhe vizita, përveç në rrethana të jashtëzakonshme; (Neni 37 (c) CRC)

Çdo fëmijë i privuar nga liria duhet të ketë të drejtën që t'i jepet menjëherë ndihmë juridike ose çdo ndihmë tjetër e përshtatshme, si dhe të drejtën të sfidojë vendimin për heqjen e lirisë përpara një gjykate ose një autoriteti tjetër kompetent, të pavarur dhe të paanshëm si dhe për një vendim të shpejtë për çdo rast të tillë. (Neni 37 (ç) CRC)

Shtetet palë i njohin çdo fëmijë të dyshuar, të akuzuar ose për të cilin është thënë se ka kryer shkelje të ligjit penal, të drejtën e një trajtimi të tillë, që zhvillon të fëmija ndjenjën e dinjitetit dhe të vlerës së personit, që përforcon tek ai ndjenjën e respektit të tij për të drejtat e njeriut dhe liritë themelore të të tjerëve dhe që merr parasysh moshën e fëmijës si dhe dëshirën për të ndihmuar riintegrimin e tij në shoqëri dhe në mënyrë që ai të luajë një rol konstruktiv në gjirin e saj. (Neni 40 (1) CRC)

Për këtë qëllim dhe duke pasur parasysh dispozitat përkatëse të instrumenteve ndërkombëtare, shtetet palë përkujdesen në veçanti që: (Neni 40 (2) CRC)

Asnjë fëmijë të mos jetë i dyshuar, i akuzuar ose i cilësuar për shkelje të ligjit penal për arsye të veprimeve ose mosveprimeve që nuk kanë qenë të ndaluara nga e drejta kombëtare ose ndërkombëtare në çastin kur ato janë kryer; (Neni 40 (2) (a) CRC)

Çdo fëmijë i dyshuar ose i akuzuar për shkelje të ligjit penal të ketë të paktën këto garanci: (Neni 40 (2) (b) CRC)

Të konsiderohet i pafajshëm derisa të provohet fajësia ligjërisht; (Neni 40 (2) (b) (i) CRC)

Të informohet menjëherë dhe drejtpërsëdrejti për akuzat e ngritura kundër tij, nëse është e përshtatshme, me anë të prindërve të tij ose të përfaqësuesve ligjorë dhe të ketë ndihmë juridike ose çdo ndihmë tjetër të duhur për përgatitjen dhe paraqitjen e mbrojtjes së tij; (Neni 40 (2) (b) (ii) CRC)

Çështja e tij të shqyrtohet pa vonesë nga një autoritet ose instancë gjyqësore kompetente, e pavarur dhe e paanshme, sipas një procedure të drejtë ligjore, në praninë e ndihmës juridike ose të një ndihme tjetër të përshtatshme, dhe, kur konsiderohet se kjo nuk është në interesin më të lartë të fëmijës, sidomos duke marrë parasysh moshën ose gjendjen e tij, në prani të prindërve ose përfaqësuesve të tij ligjorë. (Neni 40 (2) (b) (iii) CRC)

të mos detyrohet të dëshmojë ose të pohojë veten fajtor; të merren në pyetje ose të bëjë të merren në pyetje dëshmitarët e akuzës dhe të sigurojë paraqitjen dhe marrjen në pyetje të dëshmitarëve të mbrojtjes së tij, në kushte të barabarta. (Neni 40 (2) (b) (iv) CRC)

Në qoftë se konsiderohet se ka shkelur ligjin penal, të bëjë ankesë kundër këtij vendimi si dhe çdo masë të marrë si pasojë, para një autoriteti ose instance gjyqësore kompetente më të lartë, të pavarur dhe të paanshme, në përputhje me ligjin. (Neni 40 (2) (b) (v) CRC)

Të ndihmohet falas nga një përkthyes, në qoftë se ai nuk e kupton ose nuk e flet gjuhën që përdoret. (Neni 40 (2) (b) (vi) CRC)

Të respektohet plotësisht jeta e tij private në të gjitha fazat e procedurës. (Neni 40 (2) (b) (vii) CRC)

Përcaktojnë një moshë minimale, nën të cilën fëmijët konsiderohen të paafhtë për të shkelur ligjin penal; (Neni 40 (3) (a) CRC)

Marrin masa, sa herë që është e nevojshme dhe e dëshirueshme, për t'i trajtuar këta fëmijë pa iu drejtuar procedurës gjyqësore, me kusht që të respektohen plotësisht të drejtat e njeriut dhe mbrojtja ligjore. (Neni 40 (3) (b) CRC)

## **E drejta për respektimin e jetës private dhe familjare**

Çdokush ka të drejtë që t'i respektohet jeta private e familjare, vendbanimi dhe korrespondenca e tij. (Neni 8 (1) ECHR)

Autoriteti publik nuk mund të ndërhyjë në ushtrimin e kësaj të drejte përveçse në shkallën e parashikuar nga ligji dhe kur, në një shoqëri demokratike, kjo

masë është e domosdoshme për sigurimin kombëtar, për sigurinë publike, për mirëqënien ekonomike të vendit, për mbrojtjen e rendit ose për parandalimin e veprave penale, për mbrojtjen e shëndetit ose të moralit, ose për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të të tjerëve. (Neni 8 (2) ECHR)

## **Diskriminimi**

Gëzimi i të drejtave dhe i lirive të njohura në këtë Konventë duhet të sigurohet, pa asnjë dallim të bazuar në shkaqe të tilla si seksi, raca, ngjyra, gjuha, feja, mendimet politike ose çdo mendim tjetër, origjina kombëtare ose shoqërore, përkatësia në një minoritet kombëtar, pasuria, lindja ose çdo situatë tjetër. (Neni 14 ECHR)

Shtetet palë i njohin gruas barazinë me burrin përpara ligjit. (Neni 15 (1) CEDAW)

Shtetet palë i njohin gruas, në fushën civile, zotësi juridike të njëjtë me atë të burrit dhe mundësi të njëjta për ta ushtruar këtë zotësi. Ato i njohin asaj në mënyrë të veçantë të drejta të barabarta për të lidhur kontrata dhe për të administruar pasuri e i trajtojnë njësoj në të gjitha fazat e procedurës gjyqësore. (Neni 15 (2) CEDAW)

Në përputhje me detyrimet themelore të parashtuara në nenin 2 të kësaj Konvente, shtetet palë zotohen të ndalojnë dhe të eliminojnë diskriminimin racial në të gjitha format e tij dhe të garantojnë të drejtën e secilit për barazi përpara ligjit pa dallim race, ngjyre ose origjine etnike ose kombëtare, sidomos lidhur me gëzimin e këtyre të drejtave: (Neni 5 CERD)

E drejta e trajtimit të barabartë nga gjykatat ose nga çdo organ tjetër që administron drejtësinë; (Neni 5 (a) CERD)

E drejta e sigurisë së personit dhe e mbrojtjes së tij nga shteti kundër dhunës dhe keqtrajtimeve qoftë nga funksionarët qeveritarë, qoftë nga ndonjë grup ose institucion i veçantë; (Neni 5 (b) CERD)

Të drejtat politike, sidomos të drejtat e pjesëmarrjes në zgjedhje, e drejta e votimit apo e drejta për të qenë kandidat, sipas sistemit të votimit të përgjithshëm dhe të barabartë, e pjesëmarrjes në qeveri si dhe në drejtimin e punëve shtetërore, në

të gjitha nivelet, dhe për të pasur hyrje të barabartë në shërbimet publike; (Neni 5 (c) CERD)

Të drejtat e tjera civile, sidomos: (Neni 5 (ç) CERD)

E drejta e lëvizjes së lirë dhe e zgjedhjes së vendbanimit në territorin e një shteti; (Neni 5 (ç) (i) CERD)

E drejta e largimit nga çdo vend, duke përfshirë edhe vendin e vet, dhe e rikthimit në vendin e vet; (Neni 5 (ç) (ii) CERD)

E drejta e pjesëmarrjes së barabartë në veprimtari kulturore; (Neni 5 (d) (vi) CERD)

E drejta e lirisë së mendimit, ndërgjegjes dhe besimit fetar; (Neni 5 (ç) (vii) CERD)

E drejta e lirisë së mendimit dhe fjalës; (Neni 5 (ç) (viii) CERD)

E drejta e hyrjes në të gjitha lokalet dhe shërbimet që janë në shfrytëzim të publikut, si mjetet e transportit, hotelet, restorantet, kafenetë, sallat e shfaqjeve dhe parqet. (Neni 5 (dh))

### **E drejta për ankim efektiv**

Çdokush, të cilit i janë shkelur të drejtat dhe liritë e njohura në këtë Konventë, ka të drejtë të bëjë ankim efektiv tek një organ i vendit të tij, edhe kur shkelja është kryer nga persona që veprojnë në përmbushje të funksioneve të tyre zyrtare. (Neni 13 ECHR)

Çdo person që privohet nga liria e tij me masa arrestimi ose ndalimi ka të drejtë ankese në një gjykatë me qëllim që kjo të vendosë, pa vonesë, lidhur me ligjshmërinë e masës së ndalimit dhe të urdhërojë lirimin e tij në qoftë se ndalimi është i paligjshëm. (Neni 9 (4) ICCPR)

### **E drejta për të mos u gjykuar ose dënuar dy herë**

Askush nuk mund të ndiqet dhe të dënohet për vepër penale nëse është liruar ose për të cilën është dënuar me vendim të formës së prerë, përkatësisht nëse



procedura penale kundër tij është pushuar me vendim të formës së prerë të gjykatës ose aktakuza është refuzuar me vendim të formës së prerë të gjykatës. (Neni 4 par 1 KPPPK)

Askush nuk mund të ndiqet ose të dënohet penalisht nga juridiksionet e të njëjtit Shtet për një veprë për të cilën ai më parë ka qënë deklaruar i pafajshëm ose dënuar me një vendim gjyqësor përfundimtar në përputhje me ligjin dhe procedurën penale të këtij Shteti. (Neni 4(1), protokollin nr. 7 ECHR)

Dispozitat e paragrafit të mësipërm nuk pengojnë rihapjen e procesit, në përputhje me ligjin dhe procedurën penale të Shtetit në fjalë, në rast se fakte të reja ose të zbuluar rishtaz, ose një ves themelor në procedurën e mëparshme janë të një natyre të tillë që mund të çenojë vendimin e dhënë. (Neni 4 (2), protokollin nr. 7 ECHR)

Askush nuk mund të ndiqet ose të ndëshkohet për një veprë për të cilën ai është dënuar ose liruar njëherë në përputhje me ligjin dhe procedurën penale të çdo vendi. (Neni 14 (7) ICCPR)

## **Robëria**

Askush nuk duhet të mbahet në robëri; robëria dhe tregtia me robër janë ndaluara në të gjitha format e tyre: (Neni 8 (1) ICCPR)

Askush nuk duhet të mbahet në një gjendje nënshtrimi, (Neni 8 (2) ICCPR)

## **E drejta për dëmshpërblim**

Çdo person që është viktimë e një arrestimi ose ndalimi të paligjshëm ka të drejtë dëmshpërblimi. (Neni 9 (5) ICCPR)

Kur një person më në fund dënohet dhe kur ky dënim penal definitiv anulohet më vonë ose kur jepet falje për arsye se një fakt i ri ose një fakt i rizbuluar provon se është bërë një gabim gjyqësor, personi që ka pësuar si rezultat i këtij dënimi do të dëmshpërblehet në përputhje me ligjin, me përjashtim të rasteve kur provohet se mospërmendja e faktit të panjohur në kohën e duhur i detyrohet atij vetë tërësisht ose pjesërisht. (Neni 14 (6) ICCPR)

## **Urdhërkontrolli**

Urdhërkontrollin e ekzekuton policia gjyqësore me ndihmën e nevojshme të zyrtarëve të tjerë të policisë brenda dyzet e tetë orëve nga lëshimi i urdhrit. (Neni 241 (1) KPPPK)

Para fillimit të kontrollit policia gjyqësore ia prezenton urdhrin personit të cilit i drejtohet ky urdhër dhe atë e njofton se ka të drejtë të kontaktojë me avokatin i cili ka të drejtë të jetë i pranishëm gjatë kontrollit. (Neni 242 (1) KPPPK)

Kur personi kërkon praninë e avokatit gjatë kontrollit, policia gjyqësore shtyn kontrollin derisa të arrijë avokati, por jo më shumë se dy orë nga njoftimi i avokatit për kontroll. Ndërkohë, policia gjyqësore mund të kufizojë lëvizjen e personit përkatës dhe personave të tjerë në lokalet që do të kontrollohen. Në raste të ngutshme, policia gjyqësore mund të fillojë kontrollin edhe para mbarimit të afatit kohor për arrdhjen e avokatit. (Neni 242 (2) KPPPK)

Para fillimit të kontrollit policia gjyqësore kërkon nga personi që vullnetarisht të dorëzojë personin ose sendet që kërkohen. (Neni 242 (3) KPPPK)

Përrjashtimisht, kontrolli mund të fillojë pa prezentimin e urdhrit ose pa kërkesë të mëparshme për dorëzim të personit a të sendeve të kërkuara, kur pritet rezistencë e armatosur ose kur ka mundësi të dështojë efekti i kontrollit nëse ai nuk zbatohet menjëherë dhe pa paralajmërim ose kur kontrolli zbatohet në lokale publike. (Neni 242 (4) KPPPK)

Gjatë kontrollit të shtëpisë ose të lokaleve të tjera personi, shtëpia, lokalet ose pasuria e të cilit kontrollohen ose përfaqësuesi i tij kanë të drejtë të jenë të pranishëm. (Neni 243 (1) KPPPK)

Gjatë kontrollit të personit, shtëpisë ose lokaleve të tjera kërkohet të jenë të pranishëm dy persona të rritur si dëshmitarë. Para fillimit të kontrollit, dëshmitarët paralajmërohen që me kujdes të vëzhgojnë zbatimin e kontrollit dhe njoftohen mbi të drejtën e tyre për të bërë vërejtje, nëse kanë, për përmbajtjen e procesverbalit të kontrollit para se të nënshkruhet. (Neni 243 (2) KPPPK)

Kontrolli i një femre zbatohet vetëm nga femra dhe dëshmitarët duhet të jenë femra. (Neni 243 (3) KPPPK)

Kontrolli i lokaleve të banimit zbatohet me kujdes për të mos prishur qetësinë.

Lokalet e mbyllura, mobiljet ose sendet tjera mund të hapen me forcë vetëm kur pronari nuk është i pranishëm ose refuzon hapjen e tyre në mënyrë vullnetare. Gjatë hapjes së këtyre objekteve me kujdes duhet shmangur dëmtimeve të panevojshme. (Neni 243 (4) KPPPK)

Kontrolli i personit mund të përfshijë kontrollin intim, i cili zbatohet nga mjeku ose infermieri i kualifikuar, në pajtim me rregullat e shkencës së mjekësisë dhe me respektim të plotë të dinjitetit të personit. (Neni 243 (5) KPPPK)

Kur kontrolli zbatohet në lokalet e organit publik, kryesuesi i tij thirret të jetë i pranishëm gjatë kontrollit. (Neni 243 (6) KPPPK)

Për çdo kontroll të personit, të shtëpisë ose të lokaleve përpilohet procesverbali. Procesverbali i tillë nënshkruhet nga personi i kontrolluar ose nga personi, lokalet apo pasuria e të cilit është kontrolluar, avokati i tij nëse është i pranishëm gjatë kontrollit dhe personat, prania e të cilëve është e detyruar. Gjatë zbatimit të kontrollit mund të konfiskohen vetëm sendet dhe shkresat lidhur me qëllimin e kontrollit të caktuar. Sendet dhe shkresat e konfiskuara përfshihen dhe përshkruhen qartë në procesverbal dhe shënohen në vërtetimin që menjëherë i jepet personit sendet dhe shkresat e të cilit janë konfiskuar. (Neni 243 (7) KPPPK)

Nëse gjatë kontrollit të personit, shtëpisë ose lokaleve gjenden sende të cilat nuk kanë të bëjnë me veprën penale për të cilën është zbatuar kontrolli, por që tregojnë një vepër tjetër penale që ndiqet sipas detyrës zyrtare, këto sende gjithashtu përshkruhen në procesverbal, konfiskohen dhe menjëherë lëshohet vërtetimi për konfiskim. Prokurorit publik menjëherë i dërgohet njoftimi për fillimin e procedurës. Sendet e konfiskuara kthehen menjëherë kur prokurori publik zbulon se nuk ka bazë për ndjekje penale e as ndonjë bazë tjetër ligjore për konfiskimin e sendeve. (Neni 244 KPPPK)

Kur është e domodoshme dhe në masë të nevojshme, policia mund të hyjë në shtëpinë dhe lokalet tjera të personit dhe të zbatojë kontrollin pa urdhrin e gjyqtarit të procedurës paraprake nëse: (Neni 245 (1) KPPPK)

Personi përkatës me dije dhe me vullnet pajtohet me kontrollin; (Neni 245 (1) (1) KPPPK)

Personi thërret për ndihmë; (Neni 245 (1) (2) KPPPK)

Kryerësi i kapur në flagrancë gjatë kryerjes së veprës penale duhet arrestuar pas ndjekjes; (Neni 245 (1) (3) KPPPK)

Arsyet për mbrojtjen e njerëzve dhe pasurisë e kërkojnë një veprim të tillë (Neni 245 (1) (4) KPPPK) ose

Personi kundër të cilit është lëshuar urdhërarrest nga gjykata gjendet në shtëpi apo në lokale të tjera. (Neni 245 (1) (5) KPPPK)

Provat e mbledhura nëpërmjet kontrollit janë të papranueshme nëse: (Neni 246 KPPPK)

Kontrolli është zbatuar pa urdhër të gjyqtarit të procedurës paraprake në kundërshtim me dispozitat e këtij Kodi; (Neni 246 (1) KPPPK)

Urdhri i gjyqtarit të procedurës paraprake është lëshuar në kundërshtim me procedurën e paraparë me këtë Kod; (Neni 246 (2) KPPPK)

Përbajtja e urdhrin të gjyqtarit të procedurës paraprake është në kundërshtim me kushtet e parapara me këtë Kod; (Neni 246 (3) KPPPK)

Kontrolli është zbatuar në kundërshtim me urdhrin e gjyqtarit të procedurës paraprake; (Neni 246 (4) KPPPK)

Personat, prania e të cilëve është e detyrueshme, nuk kanë qenë të pranishëm gjatë kontrollit (neni 243, paragrafët 1 dhe 2 të këtij Kodi). (Neni 246 (5) KPPPK)

## **Liria e shprehjes**

Çdokush ka të drejtën e lirisë së shprehjes. Kjo e drejtë përfshin lirinë e mendimit dhe lirinë për të marrë ose për të dhënë informacione ose ide pa ndërhyrjen e autoriteteve publike dhe pa marrë parasysh kufijtë. Ky nen nuk i ndalon Shtetet që të vendosin regjim autorizimesh për sipërmarrjet e radiodifuzionit, të kinemasë, ose të televizionit. (Neni 10 (1) ECHR)

E drejta e lirisë së mendimit dhe fjalës; (Neni 5 (ç) (viii) CERD)

E drejta e lirisë së mendimit, ndërgjegjes dhe besimit fetar; (Neni 5 (ç) (vii) CERD)

## **Liria e tubimit dhe e organizimit**

Çdokush gëzon të drejtën e lirisë së tubimit paqësor dhe të organizimit, duke përfshirë të drejtën e themelimit, me të tjerë, të sindikatave dhe të pjesëmarrjes në to për mbrojtjen e interesave të tij. (Neni 11 (1) ECHR)

Ushtrimi i këtyre të drejtave nuk mund t'u nënshtrohet kufizimeve të tjera përveç atyre që, të parashikuara me ligj, në një shoqëri demokratike, përbëjnë masa të domosdoshme për sigurimin kombëtar, për sigurinë publike, për mbrojtjen e rendit dhe parandalimin e krimit, për ruajtjen e shëndetit ose të moralit, ose për mbrojtjen e të drejtave dhe të lirive të të tjerëve. Ky nen nuk ndalon kufizime të ligjshme të ushtrimit të këtyre të drejtave nga pjesëtarë të forcave të armatosura, të policisë ose të administratës shtetërore. (Neni 11 (2) ECHR)

E drejta e lirisë së mbledhjes dhe krijimit të organizatave paqësore; (Neni 5 (ç) (ix) CERD)

## **Veprat Penale Kundër Detyrës Zyrtare**

### **Shpërdorim i pozitës zyrtare ose i autorizimit**

Personi zyrtar i cili me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm të dobisë pasurore për vete ose për tjetrin ose për organizatën e biznesit apo të shkakimit të dëmit për personin tjetër ose për atë organizatë të biznesit shpërdoron pozitën e tij zyrtare, tejkalon kompetencat ose nuk i përmbush detyrat zyrtare dënohet me burgim deri në një vit. (Neni 339 (1) KPPK)

### **Përdorimi i paautorizuar i pasurisë**

Kushdo që pa autorizim përdor paratë, letrat me vlerë ose pasurinë tjetër të luajtshme të besuar personit në detyrë ose në përgjithësi në vendin e punës apo të cilat i janë vënë në disponim nga shërbimi, puna apo kushdo që jep pasurinë e këtuillë për shfrytëzim të paautorizuar dënohet me gjobë apo me burgim deri në tri vjet (Neni 342 KPPK)

### **Marrja e rryshfetit**

Personi zyrtar i cili kërkon ose merr dhuratë a përfitim tjetër për vete ose personin tjetër ose që pranon premtimin për dhuratë ose për ndonjë përfitim tjetër për të kryer në kuadër të autorizimeve të tij një veprim zyrtar apo një veprim tjetër të cilin ai nuk duhet ta kryejë ose të mos e kryejë një veprim zyrtar apo veprim tjetër të cilin ai duhet ose ka mundur ta kryejë dënohet me burgim prej gjashtë muajve deri në pesë vjet. (Neni 343 (1) KPPK)

Personi zyrtar i cili kërkon ose pranon dhuratë ose përfitim tjetër për vete ose për personin tjetër apo që pranon premtimin për dhuratë ose në ndonjë përfitim tjetër për të kryer në kuadër të autorizimeve të tij një veprim zyrtar apo veprim tjetër të cilin ai është dashur ta kryejë ose të mos e kryejë një veprim zyrtar apo një veprim tjetër të cilin ai nuk duhet ta kryejë, dënohet me burgim prej tre muajve deri në tri vjet. (Neni 343 (2) KPPK)

Personi zyrtar i cili pas kryerjes ose moskryerjes së një veprimi nga paragrafi 1 dhe 2 I këtij neni kërkon apo pranon dhurata ose ndonjë përfitim për vete apo për personin tjetër në lidhje me kryerjen apo moskryerjen e tillë dënohet me gjobë ose me burgim deri në një vit. (Neni 343 (3) KPPK)

### **Dhënia e rryshfetit**

Kushdo që i jep ose premtan se do t'i jep dhuratë apo përfitim tjetër personit zyrtar, që ai person të kryejë një veprim zyrtar apo veprim tjetër në kuadër të kompetencave të tij zyrtare, të cilin veprim ai nuk është dashur ta kryejë ose nuk e kryen një veprim zyrtar a veprim tjetër të cilin ai është dashur ta kryejë, ose kushdo që shërben si ndërmjetësues për t'ia dhënë rryshfetin personit zyrtar, dënohet me burgim prej tre muajve deri në tri vjet. (Neni 344 (1) KPPK)

Kushdo që jep ose premtan se do t'i jep dhuratë apo përfitim tjetër personit zyrtar, që ai person të kryejë një veprim zyrtar apo veprim tjetër në kuadër të kompetencave të tij zyrtare, të cilin veprim ai është dashur ta kryejë, ose të mos e kryejë një veprim zyrtar ose tjetër të cilin ai duhet ta kryejë, ose kushdo që shërben si ndërmjetësues për t'ia dhënë rryshfet personit zyrtar dënohet me gjobë apo burgim deri në një vit. (Neni 344 (2) KPPK)

Nëse kryerësi i veprës penale nga paragrafi 1 ose 2 i këtij neni e ka dhënë rryshfetin me kërkesën e personit zyrtar dhe ka njoftuar për veprën e kryer para se ajo të jetë zbuluar ose para se të ketë kuptuar se vepra është zbuluar, gjykata mund ta lirojë nga dënimi. (Neni 344 (3) KPPK)

### **Ushtrimi i ndikimit**

Kushdo që kërkon, merr ose pranon një ofertë ose premtim të një përparësie të padrejtë për vete ose për personin tjetër në lidhje me ushtrimin e një ndikimi të paduhur nga ana e kryerësit mbi vendimmarrjen e një personi personi zyrtar, pavarësisht nëse ndikimi është ushtruar ose pavarësisht nëse ushtrimi i supozuar shpie deri te rezultati i synuar dënohet me gjobë ose me burgim deri në dy vjet. (Neni 345 (1) KPPK)

Kushdo që premtan, ofron ose i jep në mënyrë direkte apo indirekte çfarëdo përparësie të padrejtë personit tjetër i cili ushtron ose konfirmon se ai është në

gjendje të ushtrrojë një ndikim të paduhur mbi vendimmarrjen e personit zyrtar, pavarësisht nëse ndikimi është ushtruar ose pavarësisht nëse ushtrimi i supozuar shpie deri te rezultati i synuar dënohet me gjobë ose me burgim deri në një vit. (Neni 345 (2) KPPK)

### **Falsifikimi i dokumenteve zyrtare**

Personi zyrtar ose personi përgjegjës i cili në dokumentin zyrtar ose afarist, në regjistrë zyrtar ose në shkresë shënon informacion të rremë ose nuk shënon informacionin thelbor apo me nënshkrimin e tij ose me vulën zyrtare vërteton dokumentin zyrtar a afarist, vërteton regjistrin zyrtar ose shkresën e cila përmban të dhëna të rreme ose mundëson përpilimin e dokumentit, regjistrin ose shkresës së tillë me përmbajtje të rreme dënohet me burgim prej tre muajve deri në tri vjet. (Neni 348 (1) KPPK)

Personi zyrtar ose personi përgjegjës i cili shfrytëzon dokumentin e rremë zyrtar apo afarist, regjistrin zyrtar ose shkresën sikur të ishin të vërteta në veprimtarinë e tij afariste ose i cili asgjëson, fsheh, dëmton apo në çfarëdo mënyre tjetër e bën të papërdorshëm dokumentin zyrtar ose afarist, regjistrin zyrtar ose shkresën dënohet me dënimin nga paragrafi 1 i këtij neni. (Neni 348 (2) KPPK)

### **Lirimi i kundërligjshëm i personit të privuar nga liria**

Personi zyrtar i cili në mënyrë të kundërligjshme e liron personin e privuar nga liria dhe i cili i është besuar ose e ndihmon arratisjen e tij apo i mundëson një lidhje të kundërligjshme o korrespondencë, qëllimi i së cilës është përgatitja e arratisjes dënohet me burgim prej tre muajve deri në pesë vjet. (Neni 350 KPPK)

### **Përvetësimi i kundërligjshëm i pasurisë me rastin e bastisjes apo ekzekutimit të vendimit gjyqësor**

Personi zyrtar i cili gjatë bastisjes së lokaleve, personit ose gjatë ekzekutimit të vendimit gjyqësor merr pasurinë e luajtshme me qëllim të përfitimit të dobisë pasurore për vete ose për personin tjetër, dënohet me burgim prej gjashtë muaj deri në pesë vjet. (Neni 351 KPPK)



## Listë faqesh dhe adresash interneti për të drejtat e njeriut

OSCE - Organization for Security and Co-operation in Europe	<a href="http://www.osce.org">www.osce.org</a>
UN High Commissioner for Human Rights (Office of UNHCHR) United Nations	<a href="http://www.unhchr.ch">www.unhchr.ch</a>  <a href="http://www.un.org">www.un.org</a>
Amnesty International	<a href="http://www.amnesty.org.uk">www.amnesty.org.uk</a>
UNICEF	<a href="http://www.unicef.org">www.unicef.org</a>
UNIFEM (CEDAW)	<a href="http://www.unfem.undp.org">www.unfem.undp.org</a>
Council of Europe	<a href="http://www.coe.int">www.coe.int</a>
Human Rights Internet	<a href="http://www.hri.ca">www.hri.ca</a>
ICRC – International Committee for the Red Cross	<a href="http://www.icrc.org/ihl">www.icrc.org/ihl</a>
International Humanitarian Law Kosovo Law Centre	<a href="http://www.kosovolawcentre.org">www.kosovolawcentre.org</a>
Council for Protection of Human Rights and Freedoms, Kosovo	<a href="http://www.albanian.com/kmdlj/">www.albanian.com/kmdlj/</a>
Belgrade Centre for Human Rights	<a href="http://www.bgcenter.org.yu">www.bgcenter.org.yu</a>
European Court of Human Rights Homepage	<a href="http://www.echr.coe.int">www.echr.coe.int</a>
IHF – International Helsinki Federation for	<a href="http://www.ihf-hr.org">www.ihf-hr.org</a>
Human Rights- Homepage Helsinki Committee, Kosovo	<a href="http://www.ihf-hr.org/koshc.htm">www.ihf-hr.org/koshc.htm</a>
Helsinki Committee, Belgrade	<a href="http://www.helsinki.org.yu/">www.helsinki.org.yu/</a>
CARE	<a href="http://www.care.org">www.care.org</a>
Human Rights Watch	<a href="http://www.hrw.org">www.hrw.org</a>





